



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____ /2020

**“PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9695, DATË 19.3.2007 “PËR
PROCEDURAT E BIRËSIMIT DHE KOMITETIN SHQIPTAR TË BIRËSIMIT”, TË
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 9 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

“10. “Pëlqimi i Komitetit është vendimi i Këshillit Drejtues për përshtatshmërinë e aplikantit birësues dhe për miratimin e birësimit”.”.

Neni 2

Në nenin 4, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Komiteti mbikëqyr periodikisht të gjitha rastet e birësimeve dhe, në rastet e birësimeve ndërvendase, bashkëpunon me autoritetet qendrore të vendeve të tjera dhe agjencitë ndërmjetësuese, ku është kryer birësimi.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Komiteti mbikëqyr në mënyrë periodike institucionet e përkujdesjes sociale publike dhe jopublike ku janë sistemuar fëmijët si dhe rekomandon dhe zbaton sanksione sipas rasteve të parashikuara nga ky ligj.”.

Neni 3

Në nenin 5, pas pikës 2 shtohet pika 3 më këtë përmbajtje:

“3. Këshilli drejtues është organi më i lartë vendimmarrës i Komitetit dhe përbëhet nga kryetari, si dhe nga një përfaqësues i nivelit të mesëm ose të lartë drejtues, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin civil, i Ministrisë së Drejtësisë, i ministrisë që mbulon fushën e shëndetësisë, ministrisë që mbulon punët e jashtme, i ministrisë që mbulon fushën e rendit publik, i ministrisë që mbulon fushën e financave, i ministrisë që mbulon fushën e çështjeve sociale, Drejtuesi i Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve, një pedagog i të drejtës familjare nga universitetet publike, me kontribut akademik dhe me përvojë të paktën 10 vjet në mësimdhënie në fushën e të drejtës familjare dhe një përfaqësues i shoqatës së jetimëve.

Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë mandat 1 vjeçar, me të drejtë rikonfirmimi.”.

Neni 4

Në nenin 7, pika 2 ndryshohet më këtë përmbajtje:

2.Tarifat për shërbimet e birësimit si dhe tarifa për licencimin e agjencive ndërmjetësuese të huaja, kriteret dhe procedurat e administrimit dhe të shpërndarjes së të ardhurave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Në nenin 8, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronjat “b” dhe nën-pika “i” e shkronjës “c”, riformulohen me këtë përmbajtje:

“b) shërbimet shoqërore, strukturat e mbrojtjes së fëmijës si dhe çdo autoritet përgjegjës për kontrollin e zbatimit të legjislacionit dhe të standardeve të shërbimeve shoqërore;”

“i) njësinë për mbrojtjen e fëmijës pranë pushtetit vendor, e cila dërgon raporte pranë Komitetit;”.

2. Pika 2 ndryshon me këtë përmbajtje:

“2. Komiteti ushtron kontrole të vazhdueshme periodike, çdo 6 muaj, në institucionet e përkujdesjes për fëmijët si dhe kontrole jo të programuara, për të njohur gjendjen e fëmijëve që plotësojnë kushtet për t'u birësuar si dhe gjendjen e fëmijëve që plotësojnë kushtet për t'u deklaruar të braktisur. Kur vihen re shkelje të detyrimeve ligjore në procedurën e birësimit ose në procedurën e deklarimit të braktisjes, kryetari i Komitetit ka te drejtë:

- a) t'i propozojë autoritetit shtetëror përgjegjës, masa disiplinore për drejtuesit apo punonjësit e institucionit shtetëror të përkujdesjes sociale;
- b) të dënojë me gjobë drejtuesin e institucionit shtetëror të përkujdesjes sociale;
- c) t'i propozojë autoritetit përgjegjës për kontrollin e zbatimit të legjislacionit dhe të standardeve të shërbimeve shoqërore, heqjen e licencës për institucionet jopublike të përkujdesjes shoqërore.
- ç) të dënojë me gjobë institucionet jopublike të përkujdesjes shoqërore.

Neni 6

Në nenin 9, pikat 1, 2 dhe 3, ndryshohen me këtë përmbajtje:

- “1. Vendos për përshtatshmërinë e aplikantëve birësues, brenda 6 muajve nga paraqitja e kërkesës së tyre.
2. Lidh marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet qendrore, përgjegjëse për birësimin, të vendeve të tjera.
3. Licencon agjencitë e huaja, që punojnë në fushën e birësimit në Shqipëri, si dhe mbikëqyr dhe miraton veprimtarinë e tyre.”.

Neni 7

Në nenin 13, ndryshohet vijon:

“Neni 13

Detyrat e Sekretariatit teknik të Komitetit

Sekretariati teknik i Komitetit kryen këto detyra:

1. Harton dhe administron listat e fëmijëve që mund të birësohen brenda ose jashtë vendit, sipas kritereve dhe përcaktimeve të parashikuara në Rregulloren e Komiteti Shqiptar të Birësimeve.
2. Pranon kërkesat e paraqitura nga shtetas shqiptarë ose të huaj, rezidentë në Republikën e Shqipërisë, që dëshirojnë të birësojnë fëmijë dhe ndihmon në plotësimin e dokumentacionit.
3. Kujdeset për t'u dhënë këshillat e nevojshme në aspektin psikologjik, ligjor, social si dhe ekonomik personave, pëlqimi i të cilëve kërkohet për birësim dhe jep të dhëna në kohë për pasojat e pëlqimit të tyre dhe të birësim.

4. Ndjek procedurën pas marrjes së vendimit të përshtatshmërisë së dhënë, si dhe pas vendimit për birësim duke dërguar të gjithë informacionin dhe dokumentacionet e nevojshme autoriteteve ose agjencive përkatëse.
5. Bashkëpunon me institucionet e përkujdesit social për fëmijët, publike dhe private, brenda vendit, për të siguruar mbrojtjen e interesave të fëmijëve që janë në këto institucione.
6. Merr pëlqimin për birësim nga aplikantët birësues, apo nga agjencitë e ndërmjetësimit si dhe realizon njohjen dhe prezantimin e dosjes së fëmijës me aplikantin birësues.
7. Lehtëson procesin e transferimit të fëmijës nga vendi i origjinës në vendin pritës dhe si ndjek procedurën për njohjen e vendimit, nëpërmjet bashkëpunimit me agjencitë e licencuara si dhe autoritetet qendrore të huaja.
8. I kërkon njësisë për mbrojtjen e fëmijës pranë pushtetit vendor dhe agjencive ndërmjetësuese të dhëna për gjendjen e fëmijës së birësuar.
9. Shqyrton, verifikon dhe vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga aplikantët birësues dhe dokumentacionin e fëmijës për t'u birësuar.
10. Siguron informacion të hollësishëm për prejardhjen e fëmijës, përfshirë prejardhjen kombëtare, fetare, kulturore dhe gjuhësore.
11. Realizon intervista me aplikantët birësues dhe përgatit studimin për ta.
12. Organizon këshillime, seminare dhe veprimtari të tjera në fushën e birësimit.
13. Harton raportet pasbirësuese për periudhën pas birësimit vendas dhe monitoron dhe përcjell raportet pasbirësuese për birësimet ndërvendase.
14. Realizon studime dhe raporton në mënyrë periodike të dhëna dhe statistikore në fushën e birësimeve, si edhe kujdeset për botimin e këtyre studimeve dhe statistikave.”.

Neni 8

Neni 14, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 14
Paraqitja e kërkesës

1. Shtetasit e huaj dhe shtetasit shqiptarë me vendqëndrim të zakonshëm jashtë Republikës së Shqipërisë mund t'i drejtohen Komitetit vetëm nëpërmjet autoriteteve qendrore kompetente ose agjencive ndërmjetësuese të shtetit të vendqëndrimit të tyre të zakonshëm, të njohura si të tilla nga Komiteti.

2. Shtetasit e huaj, me vendqëndrim të zakonshëm prej dy vjetësh në Republikën e Shqipërisë, mund t'i drejtohen drejtpërdrejt Komitetit, vetëm nëse legjislacioni i tyre kombëtar e lejon birësimin.”.

Neni 9

Në nenin 15, shtohet pika 3 me përmbajtje si më poshtë vijon:

“3. Pëlqimi ose mendimi i fëmijës jepet në përputhje me parashikimet e nenit 247 te Kodit të Familjes.”.

Neni 10

Në nenin 16, pikat 2 dhe 3 shfuqizohen.

Neni 11

Në nenin 18, ndryshohet me këtë përmbajtje:

Neni 18

Dokumentacioni i aplikantit birësues

1. Aplikanti birësues paraqet në Komitet dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesën me motivimin e birësimit.
- b) Të dhënat personale për marrëdhëniet ndërpersonale të anëtarëve të familjes, informacione për pjesëtarët e familjes dhe qëndrimin e tyre ndaj birësimit.
- c) Të dhënat për gjendjen civile, si kopjen e letërnjoftimit, certifikatën e martesës, certifikatën e zgjidhjes së martesës ose të vdekjes së bashkëshortit.
- ç) Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.
- d) Vërtetim nga prokuroria që aplikanti nuk është në ndjekje penale;
- dh) Vërtetim gjykata që aplikantin nuk është në proces gjyqësor penal.
- e) Deklaratën për fëmijërinë, mënyrën e rritjes, edukimin dhe profesionin.
- ë) Raportin mjekësor dhe historinë mjekësore të familjes.
- f) Vërtetimin nga autoriteti shëndetësor që vërteton se aplikanti birësues nuk vuan nga sëmundje ngjitëse ose sëmundje të tjera të rënda që mund të vënë në rrezik jetën dhe shëndetin e fëmijës që do të birësohet.

- g) Vërtetime të punësimit, të të ardhurave dhe të pasurisë së paluajtshme.
- gj) Vërtetimin e pronësisë së banesës dhe të dhëna për kushtet e banimit.
- h) Vërtetimin e një sipërfaqjeje të mjaftueshme banimi, në pronësi apo në përdorim, si dhe të dhëna për kushtet e banimit.
- i) Deklaratën me të dhënat për gjendjen ekonomike dhe sociale.
- j) Vërtetimin, nga organet e njësisë së qeverisjes vendore të vendbanimit, për sjelljen dhe figurën morale.
- k) Deklaratën e gatishmërisë së familjarëve dhe të miqve në mbështetje të aplikantit birësues.
- l) Dy fotografi të secilit prej aplikantëve birësues.

2. Të dhënat, që do të përfshihen në deklaratat e parashikuara në shkronjat “e”, “r”, dhe “k” të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë, me propozim të Komitetit Shqiptar të Birësimit. Deklaratat përpilohen përpara noterit. Në rastin e përpilimit të këtyre deklaratave jashtë shtetit, ato paraqiten të legalizuara.

Neni 12

Neni 22, riformulohet si më poshtë vijon:

“Neni 22

Dokumentacioni i fëmijës që do të birësohet

1. Sekretariati teknik verifikon dhe vlerëson dokumentacionin për çdo fëmijë që do të birësohet si dhe Planin Individual të Mbrojtjes të përgatitur nga institucionet e përkujdesjes sociale ose njësia për mbrojtjen e fëmijës pranë pushtetit vendor. Vlerësimi i këtij dokumentacioni shërben për gjetjen e familjeve të përshtatshme, për të përballuar nevojat e fëmijës.

2. Dokumentacioni i fëmijës që do të birësohet përmban:

- a). certifikatën e lindjes;
- b) raportin për gjendjen psikologjike, fizike dhe sociale të tij;
- c) raportin për gjendjen shëndetësore ekzistuese dhe historikun mjekësor;
- ç) mendimin e fëmijës, nëse ai ka mbushur 10 vjeç, duke pasur parasysh aftësinë e tij për të arsyetuar. Kur fëmija ka mbushur moshën 12 vjeç paraqitet pëlqimi i vet;
- d) kopje të letërnjoftimit e prindërve të tij biologjikë, nëse ata njihen;
- dh) raportin me të dhëna mbi historikun mjekësor të prindërve, nëse ato dihen, informacion për shtatzaninë dhe lindjen;
- e) vendimin e gjykatës për marrjen e pëlqimit për birësim të prindit biologjik ose vendimin gjyqësor, që ka dhënë pëlqimin për birësimin e fëmijës, ose vendimin gjyqësor që e ka deklaruar fëmijën të braktisur;

- ë) planin Individual të Fëmijës, i hartuar nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës pranë pushtetit vendor;
- f) historikun e kalimit në kujdestari të fëmijës, nëse ka dhe të dhëna për kushtet në të cilat ka jetuar;
- g) hollësi rreth jetës dhe zakoneve të tij;
- gj) dy fotografi.

3. Data e lëshimit të raportit, sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës 2 të këtij neni, duhet të jetë jo më parë se dy javë nga data e dorëzimit në Komitet e dokumentacionit për birësim.”.

Neni 13

Në nenin 23, pika 2 riformulohet si më poshtë vijon:

“2. Komiteti mund të japë pëlqimin për birësim edhe pa u përmbushur ky afat, sipas parashikimeve të nenit 257 të Kodit të Familjes, duke e motivuar këtë pëlqim.”.

Neni 14

Në nenin 24, shkronja “c” ndryshon me këtë përmbajtje:

“c). afati i konsiderimit i përshtatshëm, i aplikantit birësues, është 4 vjet nga data e dhënies së vendimit nga Këshilli Drejtues.”.

Neni 15

Në nenin 25, pika 1 ndryshon si më poshtë vijon:

“1. Me dhënien e pëlqimit për çdo birësim, me propozimin e sekretariatit teknik, këshilli drejtues përcakton periudhën e provës, e cila zgjat 3 muaj.”.

Neni 16

Në nenin 29, bëhen ndryshimet si vijon:

1. Titulli i nenit riformulohet si vijon “Birësimi i fëmijës me vendqëndrim të zakonshëm jashtë vendit”.

2. Paragrafi numërohet si pikë “1” dhe riformulohet me këtë përmbajtje:

“1. Mund të birësohen nga shtetas shqiptarë ose shtetas të huaj që kanë vendqëndrim të zakonshëm në Shqipëri fëmijë, shqiptarë ose të huaj, me vendqëndrim të zakonshëm në shtete të tjera, që e kanë ratifikuar Konventën e Hagës ose kanë lidhur marrëveshje dypalëshe me autoritetet kompetente apo agjencitë, në përputhje me parimet e kësaj konvente, me kusht që:

a) fëmija të jetë deklaruar i birësueshëm nga organi kompetent i huaj dhe të jenë ndërprerë marrëdhëniet prindër-fëmijë;

b) të jetë dhënë autorizimi ose pëlqimi i nevojshëm nga autoriteti qendror i huaj ose nga ndonjë organ tjetër që barazohet me të.”.

Neni 17

Në nenin 30, pika1 riformulohet me këtë përmbajtje:

“1. Shtetasit shqiptarë, që dëshirojnë të birësojnë fëmijë të huaj ose shqiptarë, me vendqëndrim të zakonshëm jashtë Republikës së Shqipërisë, duhet t'i drejtohen Komitetit me kërkesë, së cilës t'i bashkëlidhin të gjithë dokumentacionin e parashikuar në nenin 18 të këtij ligji.”

Neni 18

Neni 36 ndryshon me këtë përmbajtje:

Neni 36

“Mbrojtja e të dhënave

1. Komiteti merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale në mbështetje dhe zbatim të legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.
2. Komiteti, në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave personale, respekton dhe përgjigjet për mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijës në procedurat e birësimit, si dhe të aplikantit/aplikantëve birësues, duke zbatuar kushtet, kriteret dhe procedurat për përpunimin e tyre, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Punonjësit e Komitetit, si dhe çdo subjekt tjetër publik apo privat, që për shkak të funksionit apo detyrës, vihet në dijeni të të dhënave të subjekteve të të dhënave personale apo proceseve birësuese, duhet të nënshkruajë një deklaratë për ruajtjen e konfidencialitetit dhe besueshmërisë gjatë dhe pas ushtrimit të funksionit apo detyrës.
4. Të gjithë punonjësit publikë dhe privatë, të cilët administrojnë të dhëna të dosjeve të fëmijëve apo aplikantit/aplikantëve birësues, nuk lejojnë njohjen ose çdo përpunim të të dhënave të regjistruara në këto dosje nga persona të paautorizuar. Këto të dhëna nuk mund të përhapen apo bëhen të ditura, përveç rasteve të parashikuara me ligj.
5. Nëse gjatë procedurave të birësimit, apo veprimtarisë së punës, lind nevoja për marrjen e autorizimit nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për një veprim të caktuar, kryetari i Komitetit paraqet kërkesë me shkrim.
6. Agjencitë ndërmjetësuese vendase, në cilësinë e kontrolluesit, detyrohen të zbatojnë të gjitha kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Për moszbatimin e përcaktimeve në pikën 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, aplikohen sanksione administrative sipas nenit 39, të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2013 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.”.”.

Neni 19

Në nenin 37 pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Prindërit birësues dhe i birësuari, kur mosha dhe niveli i pjekurisë e lejojnë, mund t'i kërkojnë Komitetit të dhëna për origjinën e të birësuarit dhe historinë e tij.”.

Neni 20

Pas nenit 37 shtohet neni 37/1 me këtë përmbajtje:

Neni 37/1

Mbledhja dhe ruajtja e të dhënave

1. Komiteti Shqiptar i Birësimit ka detyrimin e ruajtjes së të dhënave të parashikuara në nenet 18 dhe 22 të ligjit për një periudhë prej 50 vjetësh, nga momenti i miratimit të birësimit nga gjykata.
2. Për këtë qëllim, Komiteti ka detyrimin e krijimit dhe administrimit të Arkivës Digjitale dhe Fizike të të dhënave.
3. Rregulla më të hollësishme mbi krijimin, administrimin e Arkivës Digjitale dhe asaj fizike dhe të të dhënave që duhet të regjistrohen në të, përcaktohen në Rregulloren e Komitetit.

Neni 21

Pas nenit 37/1 shtohet Neni 37/2 me këtë përmbajtje:

Neni 37/2

“Sanksione

1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e mëposhtme, pavarësisht nëse përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:
 - a) Mungesa e raportimit, në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme, në Komitetin Shqiptar të Birësimeve, sipas nenit 8, pika 1, shkronja “c)”, nënparagrafi i) dhe ii) të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 20 000 lekë deri në 80 000 lekë;

b) Mungesa e paraqitjes së kërkesës për deklarimin e braktisjes së fëmijës në gjykatë, brenda afateve dhe sipas detyrimeve të parashikuara në nenin 250 të Kodit të Familjes, dënohet me gjobë nga 150 000 lekë deri në 300 000 lekë, për çdo fëmijë për të cilin nuk janë ndjekur këto procedura;

2. Për shkeljet që përbëjnë vepër penale, Komiteti, krahas dënimit për kundërvajtjet e konstatuara, sipas këtij neni, ka detyrimin të bëjë menjëherë kallëzim për ndjekje penale.”

Neni 22

Në të gjithë ligjin termi “Sekretariati Ekzekutiv” zëvendësohet me termin “Sektori Teknik” ligjin.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.